

Institucioni qëndror: AGJENCIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE UJORE						
REGJISTRI I KËRKESAVE PËR INFORMACION PUBLIK PËR VITIN 2026						
Nr. rendor	Data e kërkesës	Objekti i kërkesës	Data e përgjigjes	Përgjigje	Mënyra e përfundimit të kërkesës	Tarifa
1	22.01.2026	Zaptimi i Lumenjve te Shqiperise(ankese)	27.01.2026	Në përgjigje të ankesës tuaj, të datës 22.01.2026, nisur në adresën e email-it info@ambu.gov.al, pranë Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, me anë të cilës kërkonti informacion n ë lidhje me zaptimin e lumenjëve të Shqipërisë dhe më konkretisht zaptimin e lumit të Tërkuzës, ju sqarojmë si më poshtë vijon: Nga verifikimet e kryera në regjistrin kombëtar të lejeve/autorizimeve të dhëna nga organet e menaxhimit të burimeve ujore, rezulton se nuk kemi leje aktive përdorimi burimi uJOR, të lëshuara nga Këshilli i Basenit UJOR Ishëm. Bazuar në ligjin Nr. 29/2024 “Për Burimet Ujore”, i ndryshuar, VKM-në Nr. 335, datë 19.6.2025 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore”, strukturat monitoruese të AMBU-së, verifikuan në terren situatën, në datën 26.1.2026 nga ku rezultoi si më poshtë: Nga verifikimi i situatës në terren u konstatua: Në një segment të lumit të Tërkuzës në të dy anët e lumit, në një gjatësi prej rreth 800 m vijë lineare e lumit, përkatësisht me koordinata: KRGJSH: X - 479592.560 Y- 4585291.757 X - 479493.160 Y- 4585239.957 X - 478983.560 Y – 4585790.157 X- 479096.960 Y- 4585869.957 Janë kryer ndërhyrje në shtratin e lumit dhe përgjatë bregut të lumit në të dy anët e tij, duke depozituar dhëra/inerte etj, duke krijuar mbushje artificiale dhe reduktuar hapësirën e rrjedhjes si dhe në të gjithë këtë gjatësi shikohen mjete si ekskavatorë, kamionë gjë i cila sjell kufizim në seksionin efektiv të rrjedhjes, duke rritur potencialisht shpejtësinë lokale, erozionin anësor dhe rrezikun e përmbytjes në prurje të larta. Sa më lart, me qëllim përmbytjen e detyrimeve të parashikuara në nenet 168, 169 të ligjit nr. 29/2024, "Për burimet ujore", i përditësuar, apo akteve ligjore e nënligjore për inspektimin dhe kontrollin e territorit dhe identifikimi i kundërvajtjeve administrative”, kemi kërkuar bashkëpunimin e IKMT-së dhe ARM-së për marrjen e masave administrative sipas ligji	E plotë	Pa pagesë
2	22.01.2026	Kerkese per ndihme/Udhezim	23.01.2026	Ju informojme se pagesa e kryer me heret lidhet me formularin fillestar dhe nuk mund te transferohet apo te aplikohet per formularin e ri per pasoje, sipas procedurave ne fuqi, ky formular shoqerohet me nje pagese te re, e cila ka nje vlere te ndryshme nga pagesa e meparshme. Per te vazhduar me procesin e aplikimit, ju lutemi te plotesoni formularin perkates dhe te kryeni pagesen sipas udhezimeve te dhena. Nese keni nevojte per informacione shtese ose sqarime te metejshme, jemi ne dispozicionin tuaj,	E plotë	Pa pagesë
3	28.01.2026	Ndertim me shkelje te rende(ankese)	2.02.2026	Në përgjigje të kërkesës tuaj, të datës 28.1.2026, nisur në adresën e email-it info@ambu.gov.al, pranë Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, me anë të cilës kërkonti informacion për miratimin e një leje ndërtimi për Agroturizëm Bar Restorant Vileta Druri në Shkallnur të Durrësit në Zk.3385 konkretisht ne Pasurinë Nr. 35/2 ku konkretisht kjo pasuri është zonë 100% Natyrore sipas AKPT-se si dhe ka rezultuar shtet deri ne vitin 2019 sipas kartelave te ASHK-së , ju sqarojmë si më poshtë vijon: Nga verifikimet e kryera në regjistrin kombëtar të lejeve/autorizimeve të dhëna nga organet e menaxhimit të burimeve ujore, rezulton se nuk kemi leje përdorimi burimi uJOR të lëshuar nga Këshilli i Basenit UJOR përkatës. Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore (AMBU) në këto raste (aplikime për vlerësim të ndikimit në mjedis), në zbatim të vendimit nr. 748 datë 1.12.2022 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e zonës, distancës dhe gjerësisë së brigjeve të burimeve ujore” vlerëson nëse këto aplikime bien apo nuk bien ndesh me trupat uJOR dhe brigjet e tyre (lumenj, përrenj, ligatina, liqene). AMBU është institucioni përgjegjës për menaxhimin e integruar, mbrojtjen, ruajtjen dhe përmirësimin e mjedisit uJOR, si dhe të ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore, në përputhje me legjislacionin në fuqi për burimet ujore. Në funksion të realizimit të qëllimit dhe objektivave të këtij ligji, AMBU harton dhe zbaton Plane të Menaxhimit të Baseneve Lumore, të cilat përfshijnë programe masash për mbrojtjen, parandalimin e përkeqësimit dhe përmirësimin e statusit ekologjik dhe kimik të trupave uJORë, promovimin e përdorimit të qëndrueshëm të ujit, si dhe garantimin e një shfrytëzimi të ekuilibruar dhe racional të burimeve ujore në shërbim të zhvillimit social-ekonomik të vendit. Pavarësisht sa më lart, bazuar në ligjin Nr. 29/2024 “Për Burimet Ujore”, i ndryshuar, dhe në VKM-në Nr. 335, datë 19.6.2025 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore”, AMBU në bashkëpunim me ZABL Ishëm – Erzen – Mat, ngriti grupin e punës për vlerësimin e situatës, ku rezultoi se: Në zonën e monitoruar që referon ankuesi janë ndërtuar disa struktura të tipit vila druri të destinuara për agro turizëm sipas deklaramit të subjektit në terren. AMBU nuk disponon dokumentacionin përkatës pasi është jashtë fushës së përgjegjësisë së institucionit tonë. Duke ju falënderuar për bashkëpunimin	E plotë	Pa pagesë

4	2.02.2026	Kërkesë për dakordësi paraprake – Përdorim i sipërfaqes ujore, Strukturë lundruese në Liqenin artificial të Tiranës ose Liqenin e Farkës	3.02.2026	Në vijim të kërkesës suaj për dakordësi paraprake – Përdorim i sipërfaqes ujore, Strukturë lundruese në Liqenin artificial të Tiranës ose Liqenin e Farkës, ju bëjmë me dije si vijon: Sipas parashikimeve të ligjit Nr.29/2024 "Për Burimet Ujore", i ndryshuar nuk njihet koncepti i dakordesisë paraprake për përdorimin e burimeve ujore, por administrimi i burimeve ujore sipas përcaktimeve në këtë ligj bëhet përmes lejeve dhe autorizimeve që leshohen nga organet e menaxhimit të burimeve ujore. Në keto rrethana ju sqarojme se, aq sa kuptohet në vijim të shqyrtimit të projekt propozimit tuaj “Për përdorimin e një pjese të sipërfaqes ujore në Liqenin artificial të Tiranës ose Liqenin e Farkës, për realizimin e një strukture lundruese të tipit restaurant (floating restaurant)" në gykimin tonë, kemi konstatuar se zhvillimi i propozuar mund të cilësohet si veprimtari që lidhet me argëtimin dhe rekreacionin. Ligji Nr.29/2024 "Për Burimet Ujore", i ndryshuar ka autorizuar Keshillin e Ministrave për të përcaktur kriteret dhe procedurat për lëshimin e lejeve dhe autorizimeve. Konkretisht, VKM-ja nr. 319, datë 11.06.2025, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për përdorim burimi ujqor, dokumenteve shoqëruese, procedurës së shqyrtimit e vendimmarrjes, formateve të lejes, autorizimit, kushteve të posaçme dhe afateve të vlefshmërisë së tyre” është aktualisht në fuqi Sipas përcaktimeve të VKM-së nr. 319, datë 11.06.2025 juve ju lind detyrimi për të ndjekur hapat procedural të përcaktuara në këtë akt nënligjor, duke plotësuar Formularin e aplikimit Nr. 13 “Kërkesë për autorizim për përdorim burimi sipërfaqësor për turizëm dhe argetim” dhe duke plotësuar dokumentacionin tekniko ligjor që i bashkëlidhet këtij aplikimi.	E plotë	Pa pagesë
5	04.02.2026	Kerkese per informacion Nr. Prot 03/26	10.02.2026	Në përgjigje të kërkesës së Drejtorit Ekzekutiv të Qendrës “Res Publica”, Av. Dorian Matlija, me nr.Prot. 03/26, datës 4.2.2026, të adresuar pranë Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, nëpërmjet adresës info@ambu.gov.al në datën 4.2.2026, në lidhje me: Sa është sasia e ujit që devijohet nga burimi/lumi përmes kanali vaditës Zhulat – Taroninë (në m³/s dhe m³/vit)? A ekzistojnë të dhëna teknike, projekte ose matje zyrtare mbi sasinë e ujit të devijuar? A është pajisur ky kanal vaditës me leje për përdorimin e burimeve ujore, sipas legjislacionit në fuqi? Nëse po, ju lutem të na vini në dispozicion kopje të lejes/leve përkatëse; Në cilën periudhë të vitit operon ky kanal vaditës? Ju informojmë, nga verifikimet e kryera në regjistrin kombëtar të lejeve/autorizimeve të dhëna nga organet e menaxhimit të burimeve ujore, rezulton se nuk kemi leje aktive përdorimi burimi ujqor, të lëshuara nga Këshilli i Basenit Lumor, dhe gjithashtu nuk kemi aplikim në sistem të këtij burimi ujqor në rastin konkret për kanalin vaditës Zhulat-Taroninë. Thënë sa më lart, për tu përgjigjur pyetjeve tuaja, nuk kemi informacion pasi ky kanal vaditës nuk figuron me leje nga organet e menaxhimit të burimeve ujore pra nuk disponojmë dokumentacion teknik (për sasinë e ujit që merr, projekte teknike si dhe për periudhën që operon). Informacionin e kërkuar mund ta siguronit nga Ministria e Bujqësisë si organ që administron këto vepra.	E plotë	Pa pagesë
6	16.02.2026	Kërkesë informacioni për përdorim burimi ujqor	17.02.2026	Në vijim të email-it tuaj, ku kërkohet ndërtimi i një moli për të ofruar shërbime me anije, shprehemi se kemi të bëjmë me një veprimtari ndërtimore në det, konkretisht me ndërtimin e një strukture ankoruese. Kjo veprimtari përfshihet në formularin Nr. 38 "Kërkesë për autorizim për përdorim burimi ujqor për ndërtimin e strukturave ankoruese, portuale dhe ishujve artificiale në trupa ujore", të VKM-së Nr.319, datë 11.06.2025 dhe bashkëlidhur këtij formulari ndodhet dokumentacioni tekniko-ligjor i cili duhet të ngarkohet (Formular të cilin po ju a vendosim bashkëlidhur). Për zhvillimin e kësaj veprimtarie, aplikohet në sistemin e-Leje "Aplikim për përdorim burimi ujqor", vetëm nga ente publike, ose nga subjekte të cilat janë pajisur me një kontratë koncesionare.	E plotë	Pa pagesë

7	17.02.2026	Kërkesë për informacion	19.02.2026	cilën kërkoni informacion në lidhje për subjektet e pajisura me leje shfrytëzimi materialesh inerte në lumin Shkumbin, ju informojmë si më poshtë vijon: Nga verifikimi i të dhënave në regjistrin kombëtar të subjekteve të pajisur me leje apo autorizim për përdorimin e burimeve ujore, konkretisht për shfrytëzimin e materialeve inerte lumore, në lumin Shkumbin, rezulton se: Në territorin e Basenit Lumor Shkumbin, kanë leje aktive për shfrytëzimin e materialeve inerte lumore, 3 subjekte (Alb - Building, ANK dhe 4-AM) Konkretisht të dhënat e detajuara, sipas kërkesës tuaj, përmbledhen në tabelën në vijim bashkangjitur:	E plotë	Pa pagesë
8	19.02.2026	Kërkesë për informacion	24.02.2026	(AMBU), nëpërmjet adresës info@ambu.gov.al, në datën 19.2.2026, në të cilën kërkoni informacion dhe dokumente në lidhje me pyetjet e dërguara, ju informojmë se çështjet e ngritura trajtohen në kuadër të menaxhimit të integruar të burimeve ujore dhe bazohen kryesisht në Planet e Menaxhimit të Baseneve Lumore (PMBL) Ishëm dhe Erzen, të cilat përbëjnë dokumentet kryesore strategjike për planifikimin, monitorimin dhe zbatimin e masave në territorin e Bashkisë Tiranë. Programi i Masave i këtyre planeve përcakton ndërhyrjet prioritare dhe rolin e institucioneve përgjegjëse, ku Bashkia Tiranë kontribuon në përmirësimin e infrastrukturës së kanalizimeve dhe trajtimit të ujërave të ndotura, rehabilitimin e trupave ujqorë, mirëmbajtjen e sistemeve ujëtare dhe zbatimin e praktikave mjedisore në territor, në bashkëpunim me institucionet kombëtare. Monitorimi i parametrave fiziko-kimikë të ujërave sipërfaqësore kryhet nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit, sipas programeve kombëtare të monitorimit dhe kërkesave të Direktivës Kuadër të Ujit, ndërsa të dhënat e monitorimit përdoren për vlerësimin e statusit ekologjik dhe kimik të trupave ujqorë. AMBU mirëmban, përditëson dhe popullon me të dhëna Regjistrin Kombëtar të Lejeve dhe Autorizimeve. Informacioni përkatës është i aksesueshëm përmes geoportalit kombëtar të Agjencisë Shtetërore të Informacionit Gjeohapësinor (ASIG) www.asig.gov.al, në përputhje me standardet kombëtare dhe kërkesat e raportimit sipas legjislacionit në fuqi. Të dhënat gjeohapësinore të publikuara në gjeoportalin kombëtar të ASIG mund ti aksesoni duke klikuar ne link https://geoportal.asig.gov.al/map/?auto=true, te shtresat e gjeoportalit, përzgjidhni “Hidrografia”, AMBU Lejet e dhëna nga KKTU dhe KBL -të. Analizat lidhur me statusin ekologjik të ujërave sipërfaqësor dhe nëntokësor, trajtohen si në dokumentet e PMBL, por edhe në Raportin e Gjendjes së Mjedisit, të përgatitur nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit, ku paraqiten të dhëna monitorimi dhe vlerësime mbi trupat ujqorë në nivel kombëtar. Në të njëjtën kohë, kategorizimi dhe tipologjia e trupave ujqorë, përfshirë liqenet dhe rezervuarët në territorin e Bashkisë Tiranë, realizohen në përputhje me kërkesat e Direktivës Kuadër të Ujit dhe metodologjitë e përcaktuara në PMBL. Inventarizimi i trupave	E plotë	Pa pagesë

				(AMBU), nëpërmjet adresës info@ambu.gov.al, në datën 20.02.2026, në të cilën kërkoni informacion dhe dokumente në lidhje me pyetjet e drejtuara, ju informojmë si më poshtë: Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore, në kuadër të menaxhimit të integruar të burimeve ujore, koordinon dhe mbështet procesin e monitorimit të gjendjes cilësore dhe sasiore të ujërave në nivel kombëtar, në bashkëpunim me institucionet teknike përgjegjëse. Të dhënat e monitorimit përdoren për planifikimin dhe menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve ujore dhe integrohen në Planet e Menaxhimit të Baseneve Lumore, të cilat përbëjnë bazën strategjike për menaxhimin e ujërave në vend. Lidhur me PMBL-të që janë aktualisht në fuqi, ku dhe Parku Shebenik-Jabllanicë ndodhet (në dy basene lumore Drin-Bunë dhe Shkumbin), informacionin që kërkoni mund të gjendet në dokumentat e poshtë shënuar: • Plani i Menaxhimit të Basenit Ujor Drin–Bunë 2021–2026, miratuar me VKM nr. 849, datë 04.11.2020; • Dokumentin e Deklaratën e problematikave të rëndësishme të menaxhimit të burimeve ujore në basenin lumor, për Planin e Dytë të Menaxhimit të Basenit Lumor Drin-Bunë, publikuar në faqen zyrtare të AMBU, që mund ta aksesoni në link-un: https://ambu.gov.al/portal/apps/sites/#/ambu/pages/konsultimi-me-publikun-perzhvillimin-e-planit-te-menaxhimit-te-basenit-lumor-drin-buna. Ju ftojmë të bëheni pjesë e konsultimit publik duke shprehur komentet tuaja në link-un e formularit elektronik për dhënie komentesh. • Dokumentin e Deklaratën e problematikave të rëndësishme të menaxhimit të burimeve ujore në basenin lumor, për Planin e Menaxhimit të Basenit Lumor Shkumbin, publikuar në faqen zyrtare të AMBU, që mund ta aksesoni në link-un: https://ambu.gov.al/portal/apps/sites/#/ambu/pages/konsultim-me-publikun-perzhvillimin-e-planit-te-menaxhimit-te-basenit-ujor-shkumbin?preview=true. Ju ftojmë të bëheni pjesë e konsultimit publik duke shprehur komentet tuaja në link-un e formularit elektronik për dhënie komentesh. AMBU mirëmban, përditëson dhe popullon me të dhëna Regjistrin Kombëtar të Lejeve dhe Autorizimeve. Të dhënat për lejet/autorizimet janë publikuar në gjeoportalin kombëtar të		
9	20.02.2026	Kërkesë për informacion	24.02.2026	Në lidhje me kërkesën tuaj, të paraqitur pranë Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore (AMBU), nëpërmjet adresës info@ambu.gov.al, në datën 25.2.2026, në të cilën kërkoni informacion dhe dokumente në lidhje me pyetjet e mëposhtme, si edhe në vijim të komunikimit për të plotësuar sqarimet e mëparshme, ju informojmë sa më poshtë, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe kompetencat institucionale të Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore (AMBU). Në lidhje me matjet e prurjeve ujore në rang vendi, sqarojmë se monitorimi sasior i ujërave sipërfaqësore nuk kryhet drejtpërdrejt nga AMBU, por nga Instituti i Gjeoshkencave (IGJEO), i cili është autoriteti teknik kompetent për këtë funksion sipas organizimit institucional përkatës. AMBU përdor të dhënat e disponueshme në kuadër të planifikimit dhe menaxhimit të burimeve ujore, bazuar në Planet e Menaxhimit të Baseneve Lumore në fuqi. Në ushtrimin e kompetencave të saj, AMBU dhe Zyrat e Administrimit të Baseneve Lumore kryejnë monitorim administrativ të subjekteve që disponojnë leje përdorimi, me fokus edhe respektimin e rrjedhës ekologjike. Nga monitorimet periodike dhe verifikimet në terren janë evidentuar vetëm raste të veçanta problematike, të cilat janë trajtuar përmes procedurave administrative, duke kërkuar korrigjimin e situatës dhe, kur ka qenë e nevojshme, duke referuar rastet pranë institucioneve përgjegjëse të inspektimit për marrjen e masave sipas ligjit. Sa i përket vetë-raportimit, sqarojmë se legjislacioni aktual nuk parashikon detyrim për raportim periodik të subjekteve pranë AMBU-së; detyrimet e tyre lidhen kryesisht me përmbushjen e kushteve të lejeve dhe paraqitjen e dokumentacionit përkatës gjatë procedurave të aplikimit apo rinovimit të tyre. Në lidhje me Kadastrën Kombëtare të Burimeve Ujore, kjo është krijuar si sistem informacioni gjeohapësinor për regjistrimin e të dhënave mbi përdorimet e burimeve ujore. Aktualisht sistemi është në procces së mirëmbajtjes teknike, AMBU ka vijuar të mirëmbajë dhe përditësojë Regjistrin Kombëtar të Lejeve dhe Autorizimeve, me të dhëna gjeohapësinore përmes gjeoportalit kombëtar të ASIG.	E plotë	Pa pagesë
10	17.02.2026	Kerkese per informacion	3.3.2026		E plotë	Pa pagesë

				cilën kërkoni informacion në lidhje për subjektet e pajisura me leje shfrytëzimi materialesh inerte në lumin Shkumbin dhe më gjerë, ju informojmë si më poshtë vijon: Referuar Ligjit Nr. 29/2024 “Për Burimet Ujore” i ndryshuar, sipas pikës 1, të nenit 137: “Organet e menaxhimit të burimeve ujore lëshojnë leje për shfrytëzimin e materialeve inerte, si: rërë, zhavorr, që nxirren nga shtretërit e lumenjve, përrenjve, liqeneve me ose pa ujë”, sipas pikës 2, po të këtij neni: “Këshilli Kombëtar i Territorit dhe Ujit përcakton kushtet dhe kriteret për dhënien e lejeve për shfrytëzimin e materialeve inerte”, ju informojmë mbi subjektet e pajisura me leje aktive për marrje materialesh inertesh dhënë nga KBL-të dhe KKTU-ja. Vlen të theksohet që subjektet të cilat janë të pajisura me leje për marrje inertesh lumore nga organet e menaxhimit të burimeve ujore (KBL, KKTU), janë bazuar në Ligjin Nr.29/2024 dhe VKM-së Nr. 319, datë 11.06.2025, "Për miratimin e formularëve të kërkesës për përdorim burimi ujqor, dokumenteve shoqëruese, procedurës së shqyrtimit e vendimmarrjes, formateve të lejes, autorizimit, kushteve të posaçme dhe afateve të vlefshmërisë së tyre", ku trajtohen aplikimet në sistem me dokumentacionin përkatës bazuar në dispozitat ligjore, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në VKM Nr.319, ku në vijim propozojnë pranë Këshillit të Basenit Lumor ose Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit përkatës trajtimin dhe miratimin e lejes. Nga verifikimi në Regjistrin Kombëtar të Licencave, Autorizimeve dhe Lejeve për përdorimin e burimeve ujore, konkretisht për shfrytëzimin e materialeve inerte lumore rezultojnë me Leje Përdorimi Burimi Ujqor, 4-subjekte që e kryejnë këtë aktivitet në lumin Shkumbin, sipas tabelës së më poshtme: NR SUBJEKTI BASENI UJJOR Dt. Leje/Autorizim Dt. Perfundimi Leje/Autorizim INERTE Vol. total Shfrytezim m3 SASITE E MARRA deri 28.2.2026 Detaje te Qellimit Emri i Burimit 1 ALB-BUILDING Shkumbin 4.8.2023 sipas kontrates por jo me shume se 4.8.2026 619637 506 000 për zbatimin e projektit “Zgjerimi i rrugës Elbasan Qafi Thanë, (Faza 1)” Lumi Shkumbin 2 ANK Shkumbin 19.12.2024 Sipas grafikut te punimeve por jo me shume se 3 vjet 19.12.2027		
11	25.02.2026	Kerkese per informacion	04.03.2026		E plotë	Pa pagesë
12	27.02.2026	Kerkese per informacion	04.03.2026	(AMBU), nëpërmjet adresës info@ambu.gov.al, në datën 27.2.2026, në të cilën kërkoni informacion dhe dokumente në lidhje me pyetjet e dërguara, ju informojmë sa më poshtë, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe kompetencat institucionale të Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore (AMBU). Informacioni mbi rezervuarët dhe digat në administrim të Bashkisë Tiranë, si dhe për çështjet specifike që lidhen me rezervuarin e Tufinës dhe digën e Liqenit Artificial, ju bëjmë me dije se, bazuar në kuadrin ligjor në fuqi dhe ndarjen e përgjegjësiive institucionale, këto çështje nuk bëjnë pjesë në fushën e kompetencave administrative dhe funksionale të Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore (AMBU). Referuar nenit 9 të Ligjit Nr. 29/2024 “Për Burimet Ujore” i ndryshuar, AMBU ka rol në hartimin e politikave, planeve dhe instrumenteve të menaxhimit të burimeve ujore, koordinimin ndërinstitutional, në kuadër të menaxhimit të integruar të baseneve ujore. Kompetencat e AMBU-së nuk përfshijnë administrimin teknik, operimin, mirëmbajtjen apo sigurinë strukturore të digave dhe rezervuarëve që janë në pronësi ose administrim të njësiive të vetëqeverisjes vendore. Në këtë kontekst, sqarojmë se, në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1108, datë 30.12.2015, infrastruktura e ujitjes dhe kullimit, përfshirë edhe rezervuarët për ujitje dhe sigurinë e digave përkatëse, është transferuar në përgjegjësi të bashkive, të cilat janë institucionet kompetente për administrimin, mirëmbajtjen dhe menaxhimin e tyre. Po ashtu, çështjet që lidhen me zhvillimin urban, lejet e ndërtimit, konsultimet me organet e planifikimit territorial apo dokumentacionin teknik të projekteve infrastrukturore, janë në kompetencë të autoriteteve të planifikimit dhe zhvillimit të territorit. Në lidhje me pyetjet mbi analizat për ndotjen bakteriale të Liqenit Artificial, publikimin e këtyre të dhënave dhe vlerësimin e sigurisë për aktivitete rekreative, sqarojmë se AMBU nuk është institucioni përgjegjës për monitorimin laboratorik të parametrave mikrobiologjikë. Informacioni mbi gjendjen dhe statusin ekologjik të trupave ujqorë, përfshirë Liqenin Artificial, është i reflektuar në Planin e Menaxhimit të Basenit Lumor Ishëm 2024-2029, ku paraqitet		

13	02.03.2026	Kerkese per koment	3.03.2026	cilën kërkoni informacion në lidhje për subjektet e pajisura me leje shfrytëzimi materialesh inerte në lumin Shkumbin, ju informojmë si më poshtë vijon: Referuar Ligjit Nr. 29/2024 “Për Burimet Ujore” i ndryshuar, sipas pikës 1, të nenit 137: “Organet e menaxhimit të burimeve ujore lëshojnë leje për shfrytëzimin e materialeve inerte, si: rërë, zhavorr, që nxirren nga shtretërit e lumenjve, përrenjve, liqeneve me ose pa ujë”, sipas pikës 2, po të këtij neni: “Këshilli Kombëtar i Territorit dhe Ujit përcakton kushtet dhe kriteret për dhënien e lejeve për shfrytëzimin e materialeve inerte”, dhe sipas pikës 1, të nenit 168: “Kontrolli për verifikimin e respektimit të kërkesave ligjore bëhet nga struktura përgjegjëse inspektuese për mbrojtjen e territorit, organet përgjegjëse për inspektimin e mjedisit, në përputhje me këtë ligj, ligjin për inspektimin dhe aktet ligjore e nënligjore për funksionimin e tyre, kryesisht apo me kërkesë të Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore”, si edhe sipas pikës 2, të po këtij neni: “Kur konstaton shkeljen e dispozitave të këtij ligji, struktura përgjegjëse inspektuese për mbrojtjen e territorit vendos dënimin kryesor me gjobë, si dhe dënime të tjera plotësuese, duke përfshirë detyrimin për rregullimin e pasojave të ardhura te burimet ujore ose detyrimin për shpërblimin e dëmit përkatës apo kthimin në gjendjen e mëparshme”, ju informojmë mbi subjektet e pajisura me leje aktive për marrje materialesh inertesh dhënë nga KBL-të dhe KKTU-ja. Nga verifikimi në Regjistrin Kombëtar të Licencave, Autorizimeve dhe Lejeve për përdorimin e burimeve ujore, konkretisht për shfrytëzimin e materialeve inerte lumore rezultojnë me Leje Përdorimi Burimi Ujor, 4-subjekte që e kryejnë këtë aktivitet në lumin Shkumbin, sipas tabelës së më poshtme: NR SUBJEKTI BASENI UJOR Dt. Leje/Autorizim Dt. Perfundimi Leje/Autorizim INERTE Vol. total Shfytezim m3 SASITE E MARRA deri 28.2.2026 Detaje te Qellimit Emri i Burimit 1 ALB-BUILDING Shkumbin 4.8.2023 sipas kontrates por jo me shume se 4.8.2026 619637 506 000 (ne përfundim) për zbatimin e projektit “Zgjerimi i rrugës Elbasan Qafi Thanë, (Faza 1)” Lumi Shkumbin 2 ANK Shkumbin 19.12.2024	E plotë	Pa pagesë
14	3.03.2026	kerkese per informacion	05.03.2026	cilën kërkoni informacion në lidhje për subjektet e pajisura me leje shfrytëzimi materialesh inerte në basenet lumore, ju informojmë si më poshtë vijon: Referuar Ligjit Nr. 29/2024 “Për Burimet Ujore” i ndryshuar, sipas pikës 1, të nenit 137: “Organet e menaxhimit të burimeve ujore lëshojnë leje për shfrytëzimin e materialeve inerte, si: rërë, zhavorr, që nxirren nga shtretërit e lumenjve, përrenjve, liqeneve me ose pa ujë”, sipas pikës 2, po të këtij neni: “Këshilli Kombëtar i Territorit dhe Ujit përcakton kushtet dhe kriteret për dhënien e lejeve për shfrytëzimin e materialeve inerte”, ju informojmë mbi subjektet e pajisura me leje aktive për marrje materialesh inerte dhënë nga KBL-të dhe KKTU-ja. Nga verifikimi në Regjistrin Kombëtar të Licencave, Autorizimeve dhe Lejeve për përdorimin e burimeve ujore, konkretisht për shfrytëzimin e materialeve inerte lumore rezultojnë me Leje Përdorimi Burimi Ujor, (në gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë) 9- subjekte që e kryejnë këtë aktivitet, sipas tabelës së mëposhtme: Subjekti Baseni Ujor Dt. Leje/Autorizim Dt. Perfundimi Leje/Autorizim Inerte Vol. Total Shfytezim M3 Qëllimi perdorimit Detaje te qellimit Emri i burimit ku shfrytëzohet “SALILLARI ” SH.P.K Mat 10.08.2020 Në përputhje me afatet e koncesionit 603 194 156 498 Shfrytëzim të materialeve inerte për realizimin e kontratës “Për ndërtimin, përmirësimin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e autostradës Milot–Morinë” Lumi Fan ALB-BUILDING Shkumbin 4.8.2023 Sipas kontrates por jo me shume se 4.8.2026 619 637 506 000 Në përfundim për zbatimin e projektit “Zgjerimi i rrugës Elbasan Qafi Thanë, (Faza 1)” REF-42845-09-21-2022 me Nr. 77/88/6, prot, datë 05.12.2022 Lumi Shkumbin ANK	E plotë	Pa pagesë
15	05.03.2026	Ndjekje e kërkesës me nr. prot. 327, datë 04/02/2026	06.03.2026	Në vijim të emailit tuaj, ju bëjmë me dije se lidhur me kërkesën tuaj me nr. prot. 327, datë 04.02.2026, nga ana e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore është kthyer përgjigje me shkresën nr. 268/1, datë 10.02.2026. Për lehtësi referimi, bashkëlidhur po jua ridërgojmë edhe një herë shkresën përkatëse, së bashku me linkun ku janë vendosur të dhënat, i cili është përcjellë edhe në diskun që ka shoqëruar shkresën e kthim-përgjigjes. Link: https://www.swisstransfer.com/d/7d5af5e0-263b-4219-b383-d7f670beca0b Mbetemi në dispozicion për çdo sqarim të mëtejshëm.	E plotë	Pa pagesë
16	08.03.2026	Kerkese per informacion	17.03.2026	Në lidhje me kërkesën tuaj, të paraqitur pranë Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore (AMBU), nëpërmjet adresës info@ambu.gov.al, në datën 13.3.2026, nga znj.Vranek në emër të banorëve të fshatit Biz, Biz Drac Ishëm në lidhje me dëmtimin e tubacioneve të UK Durrës dhe faturimin e tyre për ju nga kjo shoqëri, ju informojmë si më poshtë vijon : Së pari ju informojmë se, në zonën në fjalë nga verifikimi i regjistrit të lejeve/autorizimeve nuk kemi subjekt të pajisur me leje të përdorimit të burimit ujor të lëshuar nga Këshilli i Basenit Ujor, si organ i autorizuar nga dispozitat për menaxhimin e integruar të burimeve ujore. Bazuar në ligjin nr. 29/2024 “Për Burimet Ujore”, VKM Nr. 335 dt. 19.06.2025 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Burimeve Ujore”, i ndryshuar, referuar fushës së përgjegjësisë AMBU është institucion përgjegjës për mbrojtjen dhe përmirësimin e mjedisit ujor, të ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore si dhe statusit të tyre, referuar planeve të menaxhimit të burimeve ujore. Sa më lart, Bashkia Durrës dhe Ujësjiellës Kanalizimeve Durrës, marrin masat përkatëse për përmirësimin e situatës dhe sistemimin e tubacioneve.	E plotë	Pa pagesë

17	10.03.2026	Kerkese per informacion	17.03.2026	cilën kërkoni informacion në lidhje për subjektet e pajisura me leje shfrytëzimi materialesh inerte, ju informojmë si më poshtë vijon: Referuar Ligjit Nr. 29/2024 “Për Burimet Ujore” i ndryshuar, sipas pikës 1, të nenit 137: “Organet e menaxhimit të burimeve ujore lëshojnë leje për shfrytëzimin e materialeve inerte, si: rërë, zhavorr, që nxirren nga shtretërit e lumenjve, përrenjve, liqeneve me ose pa ujë”, sipas pikës 2, po të këtij neni: “Këshilli Kombëtar i Territorit dhe Ujit përcakton kushtet dhe kriteret për dhënien e lejeve për shfrytëzimin e materialeve inerte”, ju informojmë mbi subjektet e pajisura me leje aktive për marrje materialesh inerte dhënë nga KBL-të dhe KKTU-ja. Nga verifikimi në Regjistrin Kombëtar të Licencave, Autorizimeve dhe Lejeve për përdorimin e burimeve ujore, konkretisht për shfrytëzimin e materialeve inerte lumore rezultojnë me Leje Përdorimi Burimi Ujor, (në gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë) 9- subjekte që e kryejnë këtë aktivitet, sipas tabelës së mëposhtme: Subjekti Baseni Ujor Dt. Leje/Autorizim Dt. Përfundimi Leje/Autorizim Inerte Vol. Total Shfrytëzim M3 Volumi i marre deri 10.3.2025 Detaje te qëllimit (aksi rrugor) Emri i burimit ku shfrytëzohet “SALILLARI ” SH.P.K Mat 10.08.2020 Në përputhje me afatet e koncesionit 603 194 156 498 Shfrytëzim të materialeve inerte për realizimin e kontratës “Për ndërtimin, përmirësimin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e autostradës Milot–Morinë” Lumi Fan ALB-BUILDING Shkumbin 4.8.2023 Sipas kontratës por jo me shume se 4.8.2026 619 637 506 000 Në përfundim për zbatimin e projektit “Zgjerimi i rrugës Elbasan Qafi Thanë, (Faza 1)” REF-42845-09-21-2022 me Nr. 77/88/6, prot, datë 05.12.2022 Lumi Shkumbin ANK	E plotë	Pa pagesë
18	09.03.2026	Kërkesë për informacion mbi leje përdorimi uji familjar	11.03.2026	Në vijim të emai-it tuaj, ju bëjmë me dije se ju duhet të aplikoni në portalin on-line të e-albania “Aplikim për përdorim burimi uJOR”, duke zgjedhur "Kërkesë për leje për shfrytëzim uji nëntokësor për qëllime familjare (jo ujë të pijshëm, sasi <0.5 l/s)", duke plotësuar formularin e aplikimit Nr. 20 sipas VKM-së 319, datë 11.06.2025 “Për miratimin e formularëve të kërkesës për përdorim burimi uJOR, dokumenteve shoqëruese, procedurës së shqyrtimit e vendimmarrjes, formateve të lejes, autorizimit, kushteve të posaçme dhe afateve të vlefshmërisë së tyre”, dhe duke ngarkuar dokumentacionin tekniko-ligjor që i bashkëlidhet këtij formulari aplikimi, të cilin e gjeni bashkëlidhur.	E plotë	Pa pagesë
19	06.03.2026	Kërkesë për udhëzim mbi aplikimin për autorizim të përdorimit të burimeve ujore për lundrim për qëllime argëtimi	11.03.2026	Në vijim të email-it tuaj, ju bëjmë me dije se për aktivitetin tuaj, ju duhet të aplikoni në sistemin e-Leje "Aplikim për përdorim burimi uJOR", duke zgjedhur kërkesën për përdorim burimi uJOR sipërfaqësor, nënrubrikën "Kërkesë për autorizim për përdorim burimi uJOR për lundrim për qëllime të ndryshme", duke plotësuar formularin e aplikimit Nr.12 sipas VKM-së 319, datë 11.06.2025 <i>“Për miratimin e formularëve të kërkesës për përdorim burimi uJOR, dokumenteve shoqëruese, procedurës së shqyrtimit e vendimmarrjes, formateve të lejes, autorizimit, kushteve të posaçme dhe afateve të vlefshmërisë së tyre”</i>, dhe duke ngarkuar dokumentacionin tekniko-ligjor që i bashkëlidhet këtij formulari aplikimi.	E plotë	Pa pagesë
20	12.03.2026	Kerkese per informacion	25.03.2026	cilën kërkoni informacion në lidhje me menaxhimin e sedimenteve nëpër basenet lumore, ju informojmë si më poshtë vijon: Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore (AMBU) është institucioni përgjegjës për planifikimin dhe menaxhimin e integruar të burimeve ujore në nivel kombëtar, duke hartuar politika, strategji dhe plane zhvillimi që sigurojnë mbrojtjen sasiore dhe cilësore të ujërave. Në këtë kuadër, AMBU përgatit dhe zbaton planet e menaxhimit të baseneve lumore dhe planet e menaxhimit të riskut nga përmbytjet, koordinon institucionet për arritjen e objektivave mjedisore, si dhe siguron përputhshmërinë me legjislacionin dhe marrëveshjet ndërkombëtare, duke garantuar një qasje të qëndrueshme dhe të integruar në menaxhimin e burimeve ujore në Shqipëri. Lidhur me kërkesën tuaj mbi informacion për ndryshimet morfologjike në trupave uJOR referojuni dokumenteve të Planeve të Menaxhimit të Baseneve Lumore që janë aktualisht në fuqi, si më poshtë: • Plani i Menaxhimit të Basenit UJOR Drin–Bunë 2021–2026, miratuar me VKM nr. 849, datë 04.11.2020; • Plani i Menaxhimit të Basenit UJOR Seman 2021–2026, miratuar me VKM nr. 453, datë 10.06.2020; • Plani i Menaxhimit të Basenit UJOR Mat 2024–2029, miratuar me VKM nr. 833, datë 28.12.2023; • Plani i Menaxhimit të Basenit UJOR Ishëm 2024–2029, miratuar me VKM nr. 624, datë 08.11.2023; • Plani i Menaxhimit të Basenit UJOR Erzen 2024–2029, miratuar me VKM nr. 623, datë 08.11.2023. Për sa i përket informacioneve lidhur me pastrimin dhe menaxhimin e sedimenteve lumore është i ndaluar me ligj. Lejimi i këtyre aktiviteteve jepet vetëm në zbatim të Vendimit të Këshillit Kombëtar të Ujit me Nr. 1 prot., datë 07.07.2011, i ndryshuar me VKM Nr. 2 prot., datë 27.07.2012, “Për menaxhimin e shfrytëzimit të zhavorreve për ndërtimin e rrugëve”, ku theksojmë se subjektet duhet të jenë pjesë e listës së Punëve Publike për ndërtimin e rrugëve me rëndësi Kombëtare dhe Rajonale. Nga verifikimi në Regjistrin Kombëtar të Licencave, Autorizimeve dhe Lejeve për përdorimin e burimeve ujore, konkretisht për shfrytëzimin e materialeve inerte lumore rezultojnë me Leje Përdorimi Burimi Ujor, (në gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë) 9- subjekte që e kryejnë këtë aktivitet: 1. Subjekti “Salillari” shpk pajisur me leje në basenin e Matit, shfrytëzim të materialeve inerte për realizimin e kontratës “Për ndërtimin, përmirësimin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e autostradës Milot–Morinë”, vendi marrjes së inerteve në Lumin Fan. 2. Subjekti “Alb-Buildig” shpk pajisur me leje në basenin e Shkumbinit për zbatimin e projektit “Zgjerimi i rrugës Elbasan Qafi Thanë, (Faza 1)” vendi marrjes së inerteve në Lumin Shkumbin. 3. Subjekti “ANK”shpk pajisur me leje në basenin e Shkumbin, zgjerimi i rrugës "Elbasan-Qafëthane" (Faza 4) vendi marrjes së inerteve në Lumin Shkumbin (në dalje qytetit Librazhdit) 4. Subjekti “Fusha” shpk, pajisur me leje në basenin e Vjosës, shfrytëzimi i materialit inert për zbatimin e projektit: “Rikualifikimi i vijës bregdetare Vlorë-Radhimë-Orikum, Faza 2 (Loti 3)”. vendi marrjes së inerteve në përroin Vilavet Lumi Dukat 5. Subjekti “4 A-M” shpk, pajisur me leje në basenin e Shkumbinit, Zgjerimi i rrugës "Elbasan-Qafëthane" (Faza 2) vendi marrjes së inerteve në Lumin /Zallë Gostimë.	E plotë	Pa pagesë

21	08.04.2026	Kwrkesw pwr marrje informacioni	08.04.2026	Aplikimi juaj “Kërkesë për leje për përdorim burimi ujqor sipërfaqësor për prodhim hidroenergjetik, HEC MARJAN-GURA E VESHEVE”, me të dhënat: Nr. AN170720250181, datës 17.07.2025, pas plotësimit të gjithë dokumentacionit të nevojshëm, aplikimi në datë 12.08.2025, nëpërmjet portalit “e-Albania” është përcjellë për vendimmarrje në Këshillin Kombëtar të Territorit dhe Ujit Bazuar në ligjin Nr.29/2024 “Për Burimet Ujqore” i ndryshuar, pika 3, e nenit 141, parashikon se “Këshilli Kombëtar i Territorit dhe Ujit lëshon leje dhe autorizime për përdorimin e burimeve ujqore dhe për shkarkimet, në çdo rast kur veprimtaria për të cilën kërkohet leja, autorizimi, kërkon pajisjen me leje ndërtimi për miratimin e së cilës organ kompetent është Këshilli Kombëtar i Territorit dhe Ujit, sipas parashikimeve në legjislacionin për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”. Bazuar në këtë parashikim, kompetencën për miratimin e këtyre kërkesave e ka Këshilli Kombëtar i Territorit dhe Ujit. Në zbatim të nenit 9, gërmës “e”, të ligjit Nr. 29/2024 “Për burimet ujqore” i ndryshuar, ku përcaktohet se AMBU kryen të gjitha veprimet përgatitore në lidhje me materialet që do të paraqiten për shqyrtim në mbledhjet e KKTU-së, brenda fushës së përgjegjësisë që ka ky organ lidhur me menaxhimin e burimeve ujqore sipas përcaktimeve të këtij ligji, duke koordinuar marrëdhëniet me sekretariatin teknik të Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit, rol i cili kryhet nga AZHT, nëpërmjet shkresës të AMBU-së nr. 1880 prot, datë 25.8.2025, AZHT është njoftuar të përfshirë në rendin e ditës të mbledhjes së rradhës së KKTU-së edhe shqyrtimin e kërkesave për leje përdorimi burimi ujqor. Sa më sipër, pritet shqyrtimi i aplikimit në mbledhjen e rradhës së KKTU-së.	E plotë	Pa pagesë
22	14.04.2026	Kwrkesw	22.06.2026	basenit të lumit Ishëm, burimet ujqore që ndodhen në këtë zonë, mënyrën e shfrytëzimit dhe përbërjen e ujit, si dhe, në mënyrë të veçantë, informacion mbi burimin e ujit në Borizanë, i cili frekuentohet nga qytetarë për qëllime kurative, si edhe informacion i përgjithshëm mbi numrin e burimeve të tilla në nivel kombëtar dhe mënyrën e shfrytëzimit të tyre, ju informojmë si më poshtë: Bazuar në Ligjin nr. 29/2024 “Për burimet ujqore”, i ndryshuar, Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujqore (AMBU) është autoriteti përgjegjës për administrimin, mbrojtjen dhe zhvillimin e qëndrueshëm të burimeve ujqore, në përputhje me politikat kombëtare dhe ndërkombëtare. Gjithashtu, në përputhje me nenin 53, “Planet e menaxhimit të baseneve lumore”, AMBU harton planet e menaxhimit të baseneve lumore, të cilat miratohen dhe publikohen në përputhje me këtë ligj. Referuar basenit lumor Ishëm, për të cilin kërkohet informacioni, dhe duke u nisur nga detyrimet e legjislacionit shqiptar, si dhe nga kërkesat e Direktivës Kuadër të Ujit 2000/60/KE, ju informojmë se procesi i hartimit dhe miratimit të ciklit të parë të Planit të Menaxhimit të Basenit Lumor (PMBL) ka përfunduar në vitin 2024. Ky plan është miratuar me vendimin përkatës, konkretisht: Plani i Menaxhimit të Basenit Ujqor Ishëm 2024–2029, miratuar me VKM nr. 624, datë 08.11.2023. Këto plane përbëjnë dokumente strategjike që synojnë menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve ujqore, përmirësimin e cilësisë së ujërave dhe arritjen e objektivave mjedisorë në përputhje me standardet evropiane. Në kuadër të këtij plani dhe karakteristikave natyrore të basenit, zona e Ishmit paraqet gjithashtu interes të veçantë për burimet ujqore termale. Baseni i Ishmit, për sa i përket ujërave termale, përfaqëson një zonë me burime të pasura me minerale dhe me rëndësi për kurime natyrore, rehabilitim fizik, si edhe zhvillim turistik lokal. Burimet kryesore ndodhen në zonën e Bilajt (pranë Fushë-Krujës), përgjatë luginës së lumit Ishëm, dhe lidhen me çarje tektonike që mundësojnë ngritjen e ujërave të nxehta nga thellësia. Në funksion të menaxhimit dhe monitorimit të përdorimit të burimeve ujqore në këtë basen, AMBU mirëmban dhe përditësuar me të dhëna Regjistrin Kombëtar të Lejeve dhe Autorizimeve. Të dhënat për lejet/autorizimet janë publikuar në gjeoportalin kombëtar të ASIG, www.asig.gov.al. Informacioni i gjeneruar nga Regjistri është përpunuar, digjitalizuar dhe janë krijuar shapefile (datasetet për secilin qëllim përdorimi.) Përveç inventarizimit ne forme tabelore të lejeve të dhëna nga KKTU/KBL, AMBU ka krijuar informacionin gjeohapsinor për lejet e dhëna nga Këshilli Kombëtar i Territorit dhe Ujit dhe Këshillat e Baseneve Lumore për përdorimet e burimeve ujqore në vijimësi. Datasetet e krijuara janë standardizuar sipas temës “Hidrografia” dhe janë publikuar në Gjeoportalin Kombëtar të ASIG në bashkëpunim me Autoritetin Shtetëror për Informacionin Gjeohapsinor (ASIG).	E plotë	Pa pagesë
23	15.04.2026	Kwrkesw pwr informacion	16.04.2026	Në përgjigje të shkresë tuaj dërguar nëpërmjet postës elektronike, ku kërkohet informacion lidhur me mënyrën e hartimit të studimit hidrogjeologjik për puset e furnizimit me ujë në kuadër të projektit "Ndërtimi i ujësjellësit për furnizim me ujë të zonës Levan-seman", ju sqarojmë si vijon: Nëse puset e furnizimit me ujë janë të vendosura në afërsi të njëri-tjetrit, shfrytëzojnë të njëjtin akuifer dhe funksionojnë si pjesë e një skeme të integruar furnizimi me ujë, studimi hidrogjeologjik mund të hartohet si një studim i vetëm i integruar për të gjithë pus-shpimet. Brenda studimit duhet të paraqitet trajtimi i detajuar individual për secilin pus, duke përfshirë parametrat teknikë, përcaktimin e debiteve të shfrytëzimit dhe ndikimin e tyre në funksionimin e sistemit të përgjithshëm.	E plotë	Pa pagesë
24	04.04.2026	Kërkesë për informacion m	17.04.2025	Në këto kushte, nuk është e nevojshme hartimi i studimeve të veçanta hidrogjeologjike për secilin pus, për sa kohe që plotësohen kushtet e mësipërme. Subjektit i eshte kthyer pergjigje duke i vene ne dispozicion	E plotë	Pa pagesë
25	18.04.2026	Ankesw	27.04.2026	Nisur nga ankesa e përsëritur nga ana juaj (denoncim) e ardhur në emali-in zyrtar info@ambu.gov.al të Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujqore, në të cilën ngre shqetësimin e komunitetit Mesmal dhe Strelcë për sa i përket masakrës që po i bëhet lumenjve dhe përrenjve të zonës nga shfrytëzimi pa kriter i burimeve ujqore nga Hec-et ku po shkatërrohet fauna dhe flora për arsye se nuk respektojnë rjedhën ekologjike, konkretisht hec Xhengo Energji, hec Blue Star, hec ABV Konstruksion, Enren Hydro, Hec Energjia Valamara, Strelca Energji, Mp hec, Hidro Plant Korca, Balcan Green Energy, Hec Devoll Hidripaëer, ju sqarojmë si më poshtë vijon: Së pari, referuar fushës së përgjegjësisë së organeve të menaxhimit të burimeve ujqore të përcaktuar në legjislacionin për menaxhimin e burimeve ujqore, AMBU kryen monitorime të burimeve ujqore dhe mbi konstatimet e hasura i drejtohet IKMT-së për marrje masash administrative bazuar në ligjin Nr. 29/2024 “Për burimet ujqore”, i përditësuar, neni 168 “Inspektimi dhe identifikimi i kundërvajtjeve administrative”, pika 1 dhe 2, si dhe nenit 169 për sanksionet. Nga verifikimi i regjistrit të lejeve dhe autorizimeve rezultojnë që subjektet e përmendura në shkresën tuaj figurojnë me leje përdorimi burimi ujqor për prodhim hidrologjie dhënë nga Këshilli i Basenit Ujqor Seman dhe Këshilli Kombëtar i Ujit. Bazuar edhe në ligjin Nr. 29/2024 “Për Burimet Ujqore”, i ndryshuar, VKM-në Nr. 335, datë 19.6.2025 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujqore”, strukturat monitoruese të AMBU-së, verifikuan në terren situatën, në datën 23.04.2026 nga ku rezultoi: Nga monitorimi rezultoi që: E gjithë problematika e ngritur nga ju nuk qëndron, pasi nga monitorimi i kryer nga ana jonë mbi verifikimin e zbatimit të kushteve të lejeve në të gjithë hecet e sipërpërmendura nuk u konstatua që subjektet në fjalë nuk lejonin rrjedhën ekologjike, kjo edhe për arsyen se burimet ujqore ishin mbi kapacitet pasi kohet e fundit kishte shumë rreshnje shiu apo dëbore. Një problematikë e tillë na u konfirmua nga banorët e zonës lind në periudhën Qershor-Shtator kur bihen nivelet e ujit dhe përdoret uji për vaditje. Nga kontaktet e marra me subjektet, me kryetarin e bashkisë Maliq si dhe me banorët e zonës na u komunikua me përfitimet që ka zona nga realizimi i këtyre projekteve ku krahas të tjerave ju janë ndërtuar ujësjellësa për fshatrat, bërja e kanalizimeve për vaditjet e tokave bujqësorë si dhe përmisimi i rrugëve kryesore që lidhin këto fshatra.		Pa pagesë

26	28.04.2026	LEJE PER PERDORIM BURIMI UJOR NENTOKESOR	29.04.2026	Referuar procedurës që duhet ndjekur për aplikimin për leje për përdorim burimi uJOR, rinovimin, transferimin, pezullimin apo revokimin duhet ti referoheni VKM-së Nr. 319, datë 11.06.2025 “Për miratimin e formularëve të kërkesës për përdorim burimi uJOR, dokumenteve shoqëruese, procedurës së shqyrtimit e vendimmarrjes, formateve të lejes, autorizimit, kushteve të posaçme dhe afateve të vlefshmërisë së tyre”. Kjo VKM shpjegon procedurën dhe ka bashkëlidhur formatet me të cilat duhet të aplikoni sipas rastit që ju interesoheni. Bashkëlidhur linku ku mund të aksesoni VKM-në e sipërcituar. https://www.qbz.gov.al/eli/vendim/2025/06/11/319/57a47ccd-4656-4a69-aa6d-4d43a9987635	E plotë	Pa pagesë
27	21.05.2026	Kerkese per informacion	21.05.2026	Sybjektit I eshte kthyer pergjigje npermjet shpreses zyrtare me nr. Prot. 831 date 21.05.2025	E plotë	Pa pagesë
28	22.05.2026	Për aplikim për përdorim të burimit uJOR për qëllime bujqësore	26.05.2026	Referuar procedurës që duhet ndjekur për aplikimin për leje për përdorim burimi uJOR për qëllime të ndryshme (përfshirë edhe bujqësinë), rinovimin, transferimin, pezullimin apo revokimin duhet ti referoheni VKM-së Nr. 319, datë 11.06.2025 “Për miratimin e formularëve të kërkesës për përdorim burimi uJOR, dokumenteve shoqëruese, procedurës së shqyrtimit e vendimmarrjes, formateve të lejes, autorizimit, kushteve të posaçme dhe afateve të vlefshmërisë së tyre”. Kjo VKM shpjegon procedurën dhe ka bashkëlidhur formatet me të cilat duhet të aplikoni sipas rastit që ju interesoheni. Bashkëlidhur linku ku mund të aksesoni VKM-në e sipërcituar. https://www.qbz.gov.al/eli/vendim/2025/06/11/319/57a47ccd-4656-4a69-aa6d-4d43a9987635	E plotë	Pa pagesë
29	02.06.2026	Kerkese per informacion	02.06.2026	Sybjektit I eshte kthyer pergjigje npermjet shpreses zyrtare me nr. Prot. 888 date 02.06.2026	E plotë	Pa pagesë
30	03.06.2026	Kerkese per informacion_Shetitore Ksamil	03.06.2026	Sybjektit I eshte kthyer pergjigje npermjet shpreses zyrtare me nr. Prot.902 date 03.06.2026	E plotë	Pa pagesë
31	10.06.2026	Kërkesë për informacion	15.06.2026	“Kërkesë për informacion”, përmes së cilës kërkohet informacion mbi Planin e Menaxhimit të Basenit Lumor Ishëm, monitorimin e cilësisë së ujit, projekte rehabilitimi për këtë basen, institucionet përgjegjëse dhe burimet e ndotjes të identikuara në këtë basen, ju informojmë si më poshtë: Bazuar në Ligjin nr. 29/2024 “Për Burimet Ujore”, i ndryshuar, Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore (AMBU) është autoriteti përgjegjës për administrimin, mbrojtjen dhe zhvillimin e qëndrueshëm të burimeve ujore, në përputhje me politikat kombëtare dhe ndërkombëtare. Në përputhje me nenin 53, “Planet e menaxhimit të baseneve lumore”, AMBU harton planet e menaxhimit të baseneve lumore, të cilat miratohen dhe publikohen në përputhje me këtë ligj. Referuar basenit lumor Ishëm, për të cilin kërkohet informacioni, ju informojmë se është miratuar, nëpërmjet VKM nr. 624, datë 08.11.2023 “Për miratimin e Planit të Menaxhimit të Basenit UJOR Ishëm 2024–2029”. Ky dokument përbën instrumentin kryesor strategjik për menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve ujore, mbrojtjen e tyre dhe arritjen e objektivave mjedisore sipas detyrimet e legjisllacionit shqiptar, si dhe nga kërkesat e Direktivës Kuadër të Ujit 2000/60/KE. Lidhur me pyetjen 1 dhe 6, sqarojmë sa vijon: Plani i Menaxhimit të Basenit Lumor Ishëm është miratuar me VKM nr. 624, datë 08.11.2023 “Për miratimin e Planit të Menaxhimit të Basenit UJOR Ishëm 2024–2029”. Për aksesimin e këtij dokumenti mund ti referoheni link-ut: https://qbz.gov.al/eli/fz/2023/166/68b694a5-3c4a-4a4d-969e-28012fcce81a Dokumenti përmban analizën e karakteristikave të basenit, karakterizimin dhe përvijimin e trupave uJOR sipërfaqësor dhe nëntokësor, monitorimin e ujërave sipërfaqësor dhe nëntokësor, statusin ekologjik të trupave uJOR sipërfaqësor dhe nëntokësor, analizën e presioneve antropogjene, ndikimet e tyre mbi trupat uJORë dhe programin e masave të nevojshme për arritjen e objektivave mjedisore. Informacioni mbi presionet dhe burimet kryesore të ndotjes është pjesë integrale e dokumentit të PMBL Ishëm. Lidhur me pyetjen 2 dhe 3, sqarojmë sa vijon: Monitorimi i cilësisë së gjendjes së mjedisit (për ujërat sipërfaqësor dhe nëntokësor) kryhet nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM), në kuadër të Programit Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit (PKMM). Gjithashtu AKM është institucioni që monitorimin dhe administron informacionin. Gjatë fazës së hartimit të PMBL Ishëm, ku informacion është përpunuar dhe analizuar për të vlerësuar statusin ekologjik të trupave uJOR në basen, ku më shumë mund të shfletohet në dokumentin e planit të sipërcituar. Lidhur me pyetjet 4 dhe 5, sqarojmë se Plani i Menaxhimit të Basenit UJOR Ishëm 2024–2029 përfshin një Program Masash, i cili parashikon veprimet dhe ndërhyrjet që duhet të ndërmerren nga institucionet përgjegjëse për ruajtjen dhe përmirësimin e gjendjes së trupave uJORë në këtë basen. Këto masa adresojnë presionet dhe ndikimet e identikuara në basen dhe synojnë arritjen e objektivave mjedisore, në përputhje me legjisllacionin kombëtar për burimet ujore dhe kërkesat e Direktivës Kuadër të Ujit 2000/60/KE. Zbatimi i Planit të Menaxhimit të Basenit Lumor Ishëm bazohet në bashkëpunimin dhe koordinimin ndërinstitucional ndërmjet AMBU-së, institucioneve qendrore	E plotë	Pa pagesë

32	9.06.2026	Kërkesë për informacion	16.06.2026	(AMBU), nëpërmjet adresës info@ambu.gov.al, në datën 9.6.2026, në të cilën kërkoni informacion në lidhje me inspektimin e Inspektorit të Policisë Bashkiake Tiranë, z. Gazmend Kadria për bllokimin e ujit dhe ndërtim dhe bllokim rruge në njësinë Administrative Ndroq, ju informojmë si më poshtë vijon: Bazuar në Ligjin nr. 29/2024 “Për burimet ujore”, i ndryshuar, Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore (AMBU) është autoriteti përgjegjës për administrimin, mbrojtjen dhe zhvillimin e qëndrueshëm të burimeve ujore, në përputhje me politikat kombëtare dhe ndërkombëtare. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar nga Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore aktualisht nuk rezulton në Regjistrin Kombëtar të Licencave, Autorizimeve dhe Lejeve, të dhëna nga organet kompetente për përdorim të burimeve ujore, të kemi përdorues me leje për përdorimin e burimit ujqor në Njësinë Ndroq, Lagjja Alhysa. Gjithashtu në kuadër të VKM-në Nr. 335, datë 19.6.2025 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore”, bazuar në ligjin Nr. 29/2024 “Për Burimet Ujore”, i ndryshuar, strukturat monitoruese të AMBU-së, verifikuan në terren situatën, në datën 12.6.2026 nga ku rezultoi që: Nga inspektimi i kryer nga ZABL Ishëm-Erzen-Mat rezultoi që prona në fjalë ishte e rrethuar dhe konstatohej që kishte punime në trupin ujqor kryesisht në hedhje dherash dhe mbeturinash gjë e cila sillte bllokim të rrjedhës së ujit. Sa më lart, bazuar në ligjin Nr. 29/2024 “Për burimet ujore”, i ndryshuar, sipas pikës 1, të nenit 168: “Kontrolli për verifikimin e respektimit të kërkesave ligjore bëhet nga struktura përgjegjëse inspektuese për mbrojtjen e territorit, organet përgjegjëse për inspektimin e mjedisit, në përputhje me këtë ligj, ligjin për inspektimin dhe aktet ligjore e nënligjore për funksionimin e tyre, kryesisht apo me kërkesë të Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore”, si edhe sipas pikës 2, të po këtij neni: “Kur konstaton shkeljen e dispozitave të këtij ligji, struktura përgjegjëse inspektuese për mbrojtjen e territorit vendos dënimin kryesor me gjobë, si dhe dënime të tjera plotësuese, duke përfshirë detyrimin për rregullimin e pasojave të ardhura te burimet ujore ose detyrimin për shpërblimin e dëmit përkatës apo kthimin në gjendjen e mëparshme”, pra për rastin në fjalë do ti	E plotë	Pa pagesë
33	17.06.2026	Kërkesë për informacion	26.06.2026	cilën kërkoni informacion dhe dokumente në lidhje me pyetjet e mëposhtme, ju informojmë si më poshtë vijon: Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore, në kuadër të menaxhimit të integruar të burimeve ujore, koordinon dhe mbështet procesin e monitorimit të gjendjes sasiorë të ujërave në nivel kombëtar, në bashkëpunim me institucionet teknike përgjegjëse. Të dhënat e monitorimit përdoren për planifikimin dhe menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve ujore dhe integrohen në Planet e Menaxhimit të Baseneve Lumore, të dokumente strategjik për menaxhimin e ujërave në nivel baseni. Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore vepron në përputhje me kërkesat e legjislacionit për burimet ujore, Ligji nr.29/2024 “Për Burimet Ujore” i ndryshuar, si edhe me aktet nënligjore në fuqi, duke administruar dhe vlerësuar dokumentacionin që paraqitet nga subjektet në kuadër të procedurave për aplikim, miratim ose rinovim të lejeve për përdorim burimi ujqor. Informacioni dhe të dhënat që kërkohen nga subjektet përcaktohen në formularët e VKM-së 319, datë 11.06.2025 “Për miratimin e formularëve të kërkesës për përdorim burimi ujqor, dokumenteve shoqëruese, procedurës së shqyrtimit e vendimmarrjes, formateve të lejes, autorizimit, kushteve të posaçme dhe afateve të vlefshmërisë së tyre” të ndryshuar. Nga monitorimet e kryera nga strukturat përgjegjëse të menaxhimit të burimeve ujore, si dhe nga verifikimet administrative të realizuara deri, nuk janë evidentuar raste të mos përmbushjes së kushteve të lejes që lidhen me rrjedhën ekologjike për subjektet e sipërcituara. Ju informojmë se do të vijojmë me monitorimet përkatëse për të respektuar përmbushjen e detyrimeve të kushteve të lejes. Për sa i përket pyetjes Tuaj për hidrocentralet e mëposhtme: o Hec Gizavesh – subjekti “Dardania Green Energy”; o Hec Steblevë – subjekti “Pure Energy”; o Hec Qarrishtë – subjekti “IDI 2005”; o Hec Rrapun 1 & 2 – subjekti “C&S Construction”. Ju informojmë se subjektet janë të pajisura me leje për përdorim burimi ujqor, kopjet e të cilave gjenden bashkëlidhur kësaj përgjigjeje. Detyrimet dhe kufizimet përkatëse, përfshirë ato që lidhen me garantimin e rrjedhës minimale ekologjike, përcaktohen në lejet e përdorimit të burimit ujqor dhe në dokumentacionin teknik mbi bazën e të cilit ato janë miratuar, sipas legjislacionit në fuqi. Respektimi i kushteve të lejeve monitorohet nga strukturat përgjegjëse të menaxhimit të burimeve ujore. Nga verifikimet dhe monitorimet e kryera për subjektet e sipërcituara nuk janë evidentuar raste të mos përmbushjes së kushteve të lejes që lidhen me rrjedhën ekologjike. Rrjedha minimale ekologjike është një parametër që vlen vetëm për trupat sipërfaqësorë të rrjedhshëm (referuar edhe përcaktimeve të ligjit Nr. 29/2024 “Për Burimet Ujore” i ndryshuar, të gjithë përdoruesit e pajisur me leje, gjatë përdorimit të burimit ujqor duhet të respektojnë kushtet e lejes në lidhje me rrjedhën ekologjike) dhe monitorimi i vazhdueshëm i këtij elementi ndikon drejtpërdrejtë në mirë menaxhimin e burimit ujqor. Për verifikimin e respektimit të rrjedhës ekologjike, subjektet HEC që përdorin burime ujore me prurje mbi kufijtë e përcaktuar nga legjislacioni në fuqi kanë detyrimin të instalojnë sisteme monitorimi hidrologjik dhe të raportojnë periodikisht të dhënat përkatëse. Këto të dhëna, së bashku me informacionin mbi përdorimin e ujit për prodhimin e energjisë, shërbejnë si bazë për vlerësimin administrativ dhe teknik të respektimit të kushteve të lejes, përfshirë edhe garantimin e rrjedhës minimale ekologjike.	E plotë	Pa pagesë

34	18.06.2026	Kërkesë për informacion	22.06.2026	Në përgjigje të kërkesës suaj të dërguar nëpërmjet postës elektronike të Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore më datë 18.06.2026, me objekt “Kërkesë për informacion”, përmes së cilës kërkohet informacion mbi listën e plotë të liqeneve, rezervuarëve dhe trupave të tjerë ujorë që rezultojnë në pronësi, administrim ose përgjegjësi funksionale të Bashkisë Tiranë si dhe vendndodhjen e tyre, ju informojmë si më poshtë: Bazuar në Ligjin nr. 29/2024 “Për Burimet Ujore”, i ndryshuar, Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore (AMBU) është autoriteti përgjegjës për administrimin, mbrojtjen dhe zhvillimin e qëndrueshëm të burimeve ujore, në përputhje me politikat kombëtare dhe ndërkombëtare. Referuar të dhënave për hidrografinë në kufirin territorial të Bashkisë Tiranë mund t’i aksesoni në gjeoportalin kombëtar të ASIG në link: https://geoportal.asig.gov.al/map/?auto=true Klikoni te shtresa Hidrografia: Bëni aktive shtresat: 1. Rrjeti Rrjedhës Ujore; në këtë shtresë paraqiten të gjitha rrjedhat ujore (kanale, përrenj, përrenjtë e mëdhenj me tipologjinë vijë); 2. Pellg ujëmbajtës; në këtë shtresë paraqiten të gjithë rezervuarët, liqenet, gropat me tipologjinë polygon; 3. Rrjedhë ujore; në këtë shtresë paraqiten të gjithë lumenjtë dhe përrenjtë e mëdhenj me tipologjinë polygon.Gjithashtu, ju bëjmë me dije se, në përputhje me nenin 53 “Planet e menaxhimit të baseneve lumore”, AMBU harton Planet e Menaxhimit të Baseneve Lumore, të cilat miratohen dhe publikohen sipas përcaktimeve të këtij ligji. Bashkia Tiranë shtrihet në territorin e dy baseneve lumore, Ishëm dhe Erzen, për të cilat janë miratuar planet përkatëse të menaxhimit si më poshtë: 1. Plani i Menaxhimit të Basenit Ujor Ishëm 2024–2029 (VKM nr. 624, datë 08.11.2023); 2. Plani i Menaxhimit të Basenit Ujor Erzen 2024–2029 (VKM nr. 623, datë 08.11.2023). Për konsultimin e këtyre dokumenteve, mund ti referoheni lidhjeve të mëposhtme: Baseni Ujor Ishëm: https://qbz.gov.al/eli/fz/2023/166/68b694a5-3c4a-4a4d-969e-28012fcca81a Baseni Ujor Erzen: https://qbz.gov.al/eli/vendim/2023/11/08/623/3cdb1250-2eb9-483e-b689-8d3cce925f2d Këto dokumente përmbajnë instrumentin kryesor strategjik për menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve ujore, mbrojtjen e tyre dhe arritjen e objektivave mjedisore sipas detyrimit e legjislacionit shqiptar, si dhe nga kërkesat e Direktivës Kuadër të Ujit 2000/60/KE	E plotë	Pa pagesë
35	19.06.2026	Kërkesë për informacion	22.06.2026	Në vijim të emai-it tuaj ku kërkonti informacion mbi procedurat e aplikimit për leje për hapjen e një pusi, ju bëjmë me dije se ju duhet të aplikoni në portalin on-line të e-albania “Aplikim për përdorim burimi ujor”, duke zgjedhur fillimisht formularin e aplikimit Nr. 31 "Kërkesë për autorizim për kryerje shpimi nëntokësor për marrje uji (pus-shpimi)", duke plotësuar formularin e aplikimit Nr. 31 sipas VKM-së 319, datë 11.06.2025 “Për miratimin e formularëve të kërkesës për përdorim burimi ujor, dokumenteve shoqëruese, procedurës së shqyrtimit e vendimmarrjes, formateve të lejes, autorizimit, kushteve të posaçme dhe afateve të vlefshmërisë së tyre”, të ndryshuar si dhe duke ngarkuar dokumentacionin tekniko-ligjor që i bashkëlidhet këtij formulari aplikimi, të cilin e gjeni bashkëlidhur. Vetëm pasi të jeni pajisur me autorizimin përkatës nga Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore (AMBU), dhe të jetë kryer hapja e pus shpimit përkatës, ju duhet të bëni një aplikim të ri për shfrytëzimin e këtij pus shpimi për qëllime familjare, sipas formularit të aplikimit Nr.20 "Kërkesë për leje për shfrytëzim uji nëntokësor për qëllime familjare (jo ujë të pijshëm, sasi < 0.5 l/s)	E plotë	Pa pagesë
36	30.06.2026	Kërkesë për informacion mbi kanalet ujore dhe infrastrukturën hidrike në zonën Rrashbull – Porto Romano	01.07.2026	Në përgjigje të kërkesës suaj të dërguar nëpërmjet postës elektronike të Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore më datë 29.06.2026, me objekt “Kërkesë për informacion mbi kanalet ujore dhe infrastrukturën hidrike në zonën Rrashbull – Porto Romano”, përmes së cilës kërkohet informacion në kuadër të studimit paraprak për zhvillimin e një projekti industrial/teknologjik në zonën Rrashbull – Xhafzotaj, Durrës, ju informojmë si më poshtë: Bazuar në Ligjin nr. 29/2024 “Për Burimet Ujore”, i ndryshuar, Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore (AMBU) është autoriteti përgjegjës për administrimin, mbrojtjen dhe zhvillimin e qëndrueshëm të burimeve ujore, në përputhje me politikat kombëtare dhe ndërkombëtare. Referuar të dhënave për hidrografinë në kufirin territorial të Bashkisë Durrës mund t’i aksesoni në gjeoportalin kombëtar të ASIG në link: https://geoportal.asig.gov.al/map/?auto=true Klikoni te shtresa Hidrografia: Bëni aktive shtresat: 1. Rrjeti Rrjedhës Ujore; në këtë shtresë paraqiten të gjitha rrjedhat ujore (kanale, përrenj, përrenjtë e mëdhenj me tipologjinë vijë); 2. Pellg ujëmbajtës; në këtë shtresë paraqiten të gjithë rezervuarët, liqenet, gropat me tipologjinë polygon; 3. Rrjedhë ujore; në këtë shtresë paraqiten të gjithë lumenjtë dhe përrenjtë e mëdhenj me tipologjinë polygon.Gjithashtu, ju bëjmë me dije se, në përputhje me nenin 53 “Planet e menaxhimit të baseneve lumore”, AMBU harton Planet e Menaxhimit të Baseneve Lumore, të cilat miratohen dhe publikohen sipas përcaktimeve të këtij ligji. Bashkia Durrës shtrihet në territorin e dy baseneve lumore, Ishëm dhe Erzen, për të cilat janë miratuar planet përkatëse të menaxhimit si më poshtë: 1. Plani i Menaxhimit të Basenit Ujor Ishëm 2024–2029 (VKM nr. 624, datë 08.11.2023); 2. Plani i Menaxhimit të Basenit Ujor Erzen 2024–2029 (VKM nr. 623, datë 08.11.2023). Për konsultimin e këtyre dokumenteve, mund ti referoheni lidhjeve të mëposhtme: Baseni Ujor Ishëm: https://qbz.gov.al/eli/fz/2023/166/68b694a5-3c4a-4a4d-969e-28012fcca81a Baseni Ujor Erzen: https://qbz.gov.al/eli/vendim/2023/11/08/623/3cdb1250-2eb9-483e-b689-8d3cce925f2d Këto dokumente përmbajnë instrumentin kryesor strategjik për menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve ujore, mbrojtjen e tyre dhe arritjen e objektivave mjedisore sipas detyrimit e legjislacionit shqiptar, si dhe nga kërkesat e Direktivës Kuadër të Ujit 2000/60/KE. Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore nuk administron dokumentacion teknik, projekte projektimi apo studime inxhinierike që lidhen me ndërtimin, rehabilitimin, zgjerimin ose funksionimin e rrjeteve të kanaleve ujitëse, kulluese apo infrastrukturës tjetër hidroteknike. Për informacion më të specializuar teknik mbi këto çështje, mund t’u drejtoheni institucioneve përgjegjëse sipas fushës së tyre të kompetencës, si autoritetet e qeverisjes vendore ose institucionet përgjegjëse për administrimin e infrastrukturës së kullimit dhe ujitjes. Në lidhje me përdorimin e burimeve ujore për qëllime të ndryshme, sqarojmë se çdo përdorim i burimeve ujore zhvillohet në përputhje me dispozitat e Ligjit nr. 29/2024 “Për Burimet Ujore”, i ndryshuar, dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij. Procedurat e aplikimit, dokumentacioni teknik dhe ligjor shoqërues, rregullohen me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 319, datë 11.06.2025, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për përdorim burimi ujor, dokumenteve shoqëruese, procedurës së shqyrtimit e vendimmarrjes, formateve të lejes, autorizimit, kushteve të posaçme dhe afateve të vlefshmërisë së tyre”, i ndryshuar.	E plotë	Pa pagesë